

ALBTELECOM Sh.a

Te nderuar Perfaqësues të Global Compact

Më lejoni që në emër të Kompanisë më të madhe të Telefonisë Fikse në Shqipëri Albtelecom , dhe si anëtar I kësaj nisme të rëndësishme të shpreh edhe një herë mbështetjen për parimet themelore Global Compact , si ;

1. anti- korrupsioni.
2. Të drejtat e njeriut
3. Të drejtat e lidhura me të punësuarit
4. Mbrojtia e Mjedisit

Dëshiroj të theksoj se me anë të këtij raporti ne zotohemi pricnipet e Global Compact do ti bëjmë pjesë të strategjisë tonë të zhvillimit. Duke I koniseduar si principe si mjaft të rëndësishme, ne do të udhëhiqemi në punën tonë nga këto principe dhe do të respektojmë ato.

Mustafa Resit Akdogan
Drejtore I Pergjithshëm

Raporti per Kompanine ALBTELECOM

Ardhja e viteve 90 solli nje vale te re ndryshimesh ne shume sefera te jetes .Po keshtu edhe ne fushen e telekomunikacionit. Ne 5 shkurt te vitit 1992 krijohet Telekom Shqiptar si ndermarrje me vehte. Keshtu kompania Albtelecom eshte operator publik me veprimtarine me te madhe ne telefonine fikse ne vendin tone qe ofron sherbime ne zonat urbane, nderkohe qe nepermjet marredhenieve te interkoneksionit me operatoret rurale, shtrin sherbimet e Telekomunikacionit me tej, pothuajse ne te githe territorin e vendit. Aktiviteti kryesor i kompanise eshte i perqendruar ne shitjen e sherbimeve te telekomunikacioneve, ne trafikut telefonik, dhenien me qera te linjave dhe kapaciteteve te transmetimit si dhe ne ofrimin e interkoneksionit per te gjithë operatorët publike qe jane

licencuar nga ERT. Kompania ofron komunikim cilesor ne standartet europiane dhe transmetim digital, duke synuar zhvillime te reja kryesisht ne sherbimet digitale si xDSL. Synimet kryesore të kompanise jane : rritja e vazhdueshme e shkalles se penetrimit me sherbimet e saj ne qytetet dhe qendrat e tjera te banimit te vendit, rritja e cilesise dhe efijences se veprimtarise ekonomiko-financiare me qellim qe te perballoje me sukses konkurrencen ne tregun e hapur si dhe te plotesoje maksimalisht kerkesat e klienteve dhe pajtimtareve me sherbime telefonike dhe me sherbime të tjera të të tjera të telekomunikacioneve duke perfshire ketu edhe sherbimin cilsor te internetit.

Gjate harku kohor 15-vjecar kompania fikse Albtelecom, shenon shume evente te rendesishme ne zhvillimin, rritjen e cilesise si dhe ne ofrimin e shume sherbimeve te reja bashkohore per klientet e saj. Keshtu nder eventet me te rendesishme qe kane bere historine e kompanise tone jane : lidhja mikrovalore Shqiperi-Maqedoni ne vitin 1993, po keshtu nje vit me vonë do te vendosej lidhja satelitore Shqiper-Zvicer, duke lehtesuar se tepermi emigrantet atje. Albtelecom si nje operator me shume potence ne tregun e telekomunikacioneve, do te shenonte nje tjetër arritje. Per te qene me prane konsumatorit te saj ne 1996, u realizua futja e sherbimit telefonise publike me karte te parapaguar. Nderkohe per te permiresuar cilesine e transmetimit nje vit me vonë u vu ne perdorim kablli me Fiber Optike per transmetimin e trafikut nderkombetar.

Vitet 2000 do te shenonin per kompanine Albtelecom te tjera realizime si psh: rritja e kapacitetit te transmetimit nepermjet lidhjeve radio rele, ngritja per here te pare e Qendres se Supervizimit dhe Mirembajtjes se Rrjetit si dhe instalimi dhe venia ne shfrytezim i centraleve te rinj dixhitale te teknologjise Siemens dhe Alcatel. Vitet qe do te pasonin me tej per kompanine Albtelecom do te ishin edhe me obliguese karshi konsumatorit te saj. Ne vitet 2004 u realizua per here te pare projekti i Sistemit te faturimit dhe Kujdesit per Abonentin. Zgjerimi i rrjetit kryesor te internetit si dhe implementimin e teknologjise ADSL. Po keshtu marreveshjet e interkoneksionit te bera me disa operatore mobile dhe rural ka bere qe ne arken e Albtelecom te shtohen te ardhurat te majme duke i investuar ato serisht per te arritur ne vazhdimesi teknologjine me te fundit. Kompania Albtelecom, gjate viteve 2007, do te perfshihej nga nje vale e re ndryshimesh mjaft themelore.

Pas nje periudhe te gjate kohore per privatizimin e tij, ne 1 Tetor 2007, Kompania CETEL a.s (Ankara), anetare e CALIK Holding me qender ne Stamboll, ne konsorcium me Turk Telekom, do te bente pjese te veten edhe gjigandin e telefonise fikse Albtelecom-in. Ne baze te kontrates te ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, CALIK dhe Turk Telekom, u bene pronare te 76 % te aksioneve te kompanise se telefonise Fikse Albtelecom. CALIK , synon te sjell nje fryme te re bashkepunimi me stafin shqiptar, me qellim zhvillimin dhe rritjen e cilesise, në fushen e telekomunikacionit si dhe ofrimin e sherbimeve te reja bashkohore, te nje teknologjie shume te zhvilluar. CALIK me vision e tij dhe me besimin ne zhvillimin e ekonomise shqiptare eshte i gatshem te shendroje Albtelecom-in ne nje kompani moderne ne sherbim te plote te qytetareve shqiptare.

Disa nga objektivat e Albtelecomit ne te ardhmen, konsistojne ne permiresimin e sherbime duke e vene theksin ne standarte te reja te tregut, integrimin e sherbimeve telefonike, zhvillimin e Internetit dhe perhapjen e tij duke aplikuar tarifa te leverdisshme per abonentet, pergjigjen globale te nevojave te komunikimit gjithnje e ne rritje. Albtelecom po ndermerr hapat e duhura per te qene faktor vendimtar ne kete drejtim. Albtelecom, per here te pare, ne kuader te planeve strategjike per futjen e produkteve te

reja, ka projektuar investime shume te rendesishme per shtimin e kapaciteteve të centraleve në Tirane, per rritjen e numrit te aboneteve ne te gjithe Shqiperine si dhe per zhvillimin e teknologjive të informacionit dhe te komunikimit, ne menyre te vecante te Internetit. Kjo ndihet edhe me shume ne aplikimin e tarifave te reja te ADSL me cmime shume te arsyeshme dhe me nje cilesi shume te larte.

Albtelecom eshte bere pjese e Global Compact, dhe eshte perpjekur qe gjate kesaj periudhe te operoje ne peputhje te plote me detyrimet qe sjell kjo nisme e rendesishme. Pergjate vitit te fundit jane organizuar ne menyre te vazhdueshme trajnime te stafit teknik dhe menaxheriaql , ne vende te ndryshme te botes, si Turqi , Austri etj. Qellimi I ketyre trajnimeve eshte persosja e metejshme e stafit tone. Po keshtu Albtelecom operon ne menyre te kujdesshme dhe ne perputhje te plote me kontraten kolektive te firmosur mes kompanise dhe sindikates se punonjesve te Albtelecom ,duke bere te mundur garangtimin e te gjitha te drejtave per punonjesit e kompanise.

Gjithashte kompania Albtelecom ne kuader te politikave te saj per pergjegjesine sociale, per te ndihmuar komunitetin ne nevoje, ka meshtetur disa aktivitet me karakter kulturor-social,duke bere tashme qe Albtelecom te jete ure lidhese komunikimi per kedo. Kompania ka ndare nje fond te veccante pre afro 10000 euro per te mbeshtetur me sopsorizime kategori ne nevoje , si jetimet, personat me aftesi te kufizuara. Mbeshtetja e dites se jetimeve, 20 maj , me 8500 euro ishte nje nga keto projekte Ne i japim nje rendesi te vecante pergjegjegjesise sociale dhe per kete arsye do vazhdojme te mbeshtesim pa rezerva projektet qe kane te bejne me mbrojtien e mjedisit, dhe fushave te tjera sociale duke e ndjere veten edhe me te dobishem per komunitetin.